- Kur përdorni një program pa paralarje, mos vendosni detergjent të lëngshëm në ndarësen e paralarjes (ndarësja nr. "1").
- Në një program me paralarje, vendosni detergjent të lëngshëm në ndarësen e paralarjes (ndarësja nr. "1").
- Mos përzgjidhni një program me paralarje nëse do të përdorni një qeskë detergjenti ose tabletë të tretshme. Vendoseni detergjentin e pakeluar ose tabletën e tretshme direkt midis rrobave në makineri. Hiqini ato pas tharjes.
- Nëse po përdorni detergjent të lëngshëm, mos harroni ta hidhni detergjentin e lëngshëm në ndarjen e larjes kryesore (ndarja nr. 2)
- Kur lavatriça është në hapin e tharjes, mos shtoni asnjë lëndë kimike larëse (detergjent të lëngshëm, zbutës etj.).

4.7.3 Zgjedhja e detergjentit

Lloji i detergjentit që do të përdoret varet nga lloji dhe ngjyra e copave.

- Përdorni detergjentë të ndryshëm për rrobat me ngjyra dhe të bardha.
- Lajini rrobat tuaja delikate vetëm me detergjentë të veçantë (detergjentë të lëngshëm, shampo për të leshtat, etj.) që përdoren vetëm për rroba delikate.
- Kur lani rroba me ngjyra të errëta apo jorganë, rekomandohet që të përdoret detergjent i lëngshëm.
- Lajini të leshtat me detergjentë të veçantë të prodhuar posaçërisht për të leshtat.



KUJDES!

- Përdorni vetëm detergjentë të prodhuar posaçërisht për lavatriçe.
- Mos përdorni pluhur sapuni.

4.7.4 Rregullimi i sasisë së detergjentit

Sasia e detergjentit larës që duhet të përdoret varet nga sasia e rrobave, niveli i ndotjes dhe fortësia e ujit.

- Mos përdorni sasi që i tejkalojnë dozat e rekomanduara në paketimin e detergjentit për të shmangur problemet e shkurës së tepërt, shpëlarjes jo të mirë, kursimeve financiare dhe në fund, mbrojtjes së mjedisit.
- Përdorni më pak detergjent për sasi të vogla rrobash ose për rroba jo shumë të ndotura.

4.7.5 Përdorimi i zbutësve


Hidheni zbutësin në ndarësen e zbutësit të sirtarit të detergjentit.

- Mos e kaloni nivelin ($>max<$) të shënuar në ndarësen e zbutësit.
- Nëse zbutësi e ka humbur rrjedhshmërinë ose është i koncentruar, hollojeni me pak ujë para se ta vendosni në sirtarin e detergjentit.

4.7.6 Përdorimi i detergjentëve të lëngshëm


4.7.6.1 Nëse produkti ka një enë për detergjent të lëngshëm

- Hidheni mbajtësin e detergjentit të lëngshëm në ndarjen nr. "2".
- Nëse detergjenti i lëngshëm e ka humbur rrjedhshmërinë, hollojeni me ujë përpara se ta vendosni në ndarjen e detergjentit.



4.7.6.2 Nëse produkti është i pajisur me një pjesë detergjenti të lëngshëm:

- Kur doni të përdorni detergjent të lëngshëm, tërhiqeni aparatin drejt vetes. Pjesa që bie poshtë do të shërbejë si barrierë për detergjentin e lëngshëm.
- Nëse është e nevojshme, pastrojeni aparatin me ujë kur është në vend ose duke e hequr.
- Nëse do të përdorni detergjent pluhur, aparati duhet të sigurohet në pozicionin e sipërm.



4.7.6.3 Nëse produkti nuk ka enë për detergjent të lëngshëm

- Mos përdorni detergjentë të lëngshëm për paralarjen në një program me paralarje.
- Detergjenti i lëngshëm i njollos rrobat kur përdoret me funksionin e Nisjes së Vonuar. Nëse do të përdorni funksionin e Nisjes së Vonuar, mos përdorni detergjent të lëngshëm.

4.7.7 Përdorimi i detergjentit në trajtë xheli dhe tablete

- Nëse trashësia e detergjentit në trajtë xheli është e lëngshme dhe lavatriçja juaj nuk ka një enë të veçantë për detergjentin e lëngshëm, hidheni detergjentin xhel në ndarjen kryesore të detergjentit larës gjatë marrjes së parë të ujit. Nëse lavatriçja juaj ka një enë për detergjent të lëngshëm, hidheni detergjentin në këtë enë para se të filloni programin.
- Nëse trashësia e detergjentit në trajtë xheli nuk është e lëngshme ose është në formën e kapsulës së lëngshme, futeni direkt në kazan para larjes.
- Hidhni tabletat në ndarjen kryesore të larjes (ndarja nr. "2") ose direkt në kazan para larjes.



INFORMACION

- Detergjentët në trajtë tablete mund të lënë njolla në ndarjen e detergjentit. Nëse hasni mbetje të tilla, vendoseni detergjentin tabletë midis rrobave, pranë pjesës së poshtme të kazanit në larjet e tjera.



INFORMACION

- Përdorni detergjent tabletë ose xhel pa zgjedhur funksionin e paralarjes.
- Para tharjes, mos harroni të hiqni nga kazanit objekte të tilla si enët plastike të detergjentit.

4.7.8 Përdorimi i sodës së rrobave

- Shtoni sodë rrobash të lëngshme, sodë rrobash pluhur ose bojë rrobash në ndarjen e zbutësit.
- Mos përdorni zbutës dhe sodë rrobash në një cikël larjeje.
- Fshijeni pjesën e brendshme të lavatriçes me një leckë të njomë dhe të pastër pasi të keni përdorur sodë rrobash.

4.7.9 Përdorimi i zbardhuesve

- Zgjidhni një program me paralarje dhe shtoni zbardhues në fillim të paralarjes. Mos vendosni detergjent në ndarësen e paralarjes. Përndryshe, zgjidhni një program me një hap për tharje ekstra, shtoni zbardhuesin në ndarjen bosh të sirtarit të detergjentit dhe kur të shihni hapin e shpëlarjes në ekran për herë të parë, shtoni gjithashtu 1 gotë ujë në të njëjtën ndarje.
- Mos përdorni zbardhues dhe detergjent duke i përzier.
- Përdorni vetëm një sasi të vogël (rreth 50 ml) zbardhuesi dhe shpëlajini robat mirë pasi kjo mund të shkaktojë acarim të lëkurës. Mos hidhni zbardhues në rroba dhe mos e përdorni me rroba me ngjyra.

- Kur përdorni zbardhues me bazë oksigjeni, zgjidhni një program që lan në temperaturë më të ulët.
- Zbardhuesi me bazë oksigjeni mund të përdoret bashkë me detergjentin. Megjithatë, nëse ka dendësi të ndryshme, së pari shtoni detergjentin në ndarësin e detergjentit nr. "2" dhe prisni që lavatriçja të marrë detergjentin së bashku me ujin. Ndërsa pajisja vazhdon të marrë ujë, shtoni zbardhuesin në të njëjtën ndarje.

4.7.10 Përdorimi i antikalkarit

- Kur nevojitet, përdorni antikalkar të prodhuar posaçërisht vetëm lavatriçe.

4.8 Këshilla për larje të efektshme

		Rrobat			
		Ngjyra të lehta dhe të bardha	Me ngjyra	Ngjyra të zeza/të errëta	Delikate/ Të leshta/Të mëndafshta
		(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të ndotjes: 40-90°C)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të ndotjes: ftohtë -40°C)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të ndotjes: ftohtë -40°C)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të ndotjes: ftohtë -30°C)
Niveli i ndotjes	Shumë të ndotura (njolla të veshitra, të tilla si bar, kafeja, frutat dhe gjaku.)	Mund të jetë e nevojshme që njollat të para-trajtohen ose të kryhet paralarja. Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për robat e bardha mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat shumë të ndotura. Rekomandohet që të përdoren detergjentë pluhur për të pastruar njollat e baltës dhe të dheut dhe njollat që janë të ndjeshme ndaj zbardhuesve.	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për robat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat shumë të ndotura. Rekomandohet që të përdoren detergjentë pluhur për të pastruar njollat e baltës dhe të dheut dhe njollat që janë të ndjeshme ndaj zbardhuesve. Detergjentët që nuk përbëjnë zbardhues duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për robat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat shumë të ndotura.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për robat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.
	Me ndotje normale (Për shembull, njolla të shkakduara nga trupi në jeka dhe mëngë)	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për robat e bardha mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat me ndotje normale.	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për robat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat me ndotje normale. Detergjentët që nuk përbëjnë zbardhues duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për robat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat me ndotje normale.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për robat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.
	Pak të ndotura (Nuk ka njolla të dukshme.)	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për robat e bardha mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat pak të ndotura.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për robat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat pak të ndotura. Detergjentët që nuk përbëjnë zbardhues duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për robat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për robat pak të ndotura.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për robat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.

4.9 Këshilla për tharje të mirë

		Programet				
		Tharja e veshjeve prej pambuku	Tharja e veshjeve sintetike	Babyprotect +	Larja dhe tharja	Laj & Vish
Llojet e rrobave	Rroba rezistente me përmbajtje pambuku	Çarçafë krevati, mbulesa, rroba bebesh, bluza, tuta, rroba rezistente të thurura, xhinse, pantallona kanavace, këmbisha, çorape pambuku, etj.	Nuk rekomandohen!	I lan dhe than respektivisht! Çarçafë krevati, mbulesa, rroba bebesh, bluza, tuta, rroba rezistente të thurura, xhinse, pantallona kanavace, këmbisha, çorape pambuku, etj.	I lan dhe than respektivisht! Çarçafë krevati, mbulesa, rroba bebesh, bluza, tuta, rroba rezistente të thurura, xhinse, pantallona kanavace, këmbisha, çorape pambuku, etj.	Rrobat pa njolla që janë veshur për një kohë të shkurtër si këmbisha, bluza, tuta. Duhet të ngarkohet një sasi shumë e vogël rrobash.
	Rrobat sintetike (poliester, nallon, etj.)	Nuk rekomandohen!	Rekomandohet për rrobat me përmbajtje poliesteri, nalloni, poliacetati, akriliku. Nuk rekomandohet tharja për rrobat me përmbajtje viskoze. Duhet të merren parasysh shpjegimet e tharjes në etiketën e mirëmbajtjes.	Për rrobat prej poliesteri, nalloni, poliacetati, akriliku rekomandohet temperaturë e ulët duke marrë parasysh paralajmërimet e larjes dhe tharjes të dhëna në etiketën e mirëmbajtjes.	Për rrobat prej poliesteri, nalloni, poliacetati, akriliku rekomandohet temperaturë e ulët duke marrë parasysh paralajmërimet e larjes dhe tharjes të dhëna në etiketën e mirëmbajtjes.	Bluza, këmbisha dhe rroba sintetike të ndotura shumë pak dhe pa njolla. Duhet të futet një sasi shumë e vogël rrobash.
	Rroba delikate (me përmbajtje mëndafshi, lesi, kashmiri, lesi i argjente, etj.)	Nuk rekomandohen!	Nuk rekomandohen!	Nuk rekomandohen!	Nuk rekomandohen!	Nuk rekomandohen!
	Rrobat e mëdha (si jorganet, palitot, perdet, etj.)	Nuk rekomandohen! Nuk është e përshtatshme që rrobat e mëdha të thahen brenda në lavatriçe. Thajini ato duke i varur ose duke i shtrirë.	Nuk rekomandohen! Nuk është e përshtatshme që rrobat e mëdha të thahen brenda në lavatriçe. Thajini ato duke i varur ose duke i shtrirë.	Nuk rekomandohen! Nuk është e përshtatshme që rrobat e mëdha të thahen brenda në lavatriçe. Thajini ato duke i varur ose duke i shtrirë.	Nuk rekomandohen! Nuk është e përshtatshme që rrobat e mëdha të thahen brenda në lavatriçe. Thajini ato duke i varur ose duke i shtrirë.	Nuk rekomandohen! Nuk është e përshtatshme që rrobat e mëdha të thahen brenda në lavatriçe. Thajini ato duke i varur ose duke i shtrirë.

3.10 Koha e shfaqur e programit


Mund të shikoni kohëzgjatjen e programit në ekranin e lavatriçes, ndërsa zgjidhni një program. Në varësi të sasisë së rrobave që keni ngarkuar në lavatriçe, shkumëzimit, kushteve të një ngarkese të pabalancuar, luhatjeve në furnizimin me energji, presionit të ujit dhe cilësimeve të programit, kohëzgjatja e programit do të përshtatet automatikisht ndërkohë që programi është në proces.

RAST I VEÇANTE: Në fillimin e programeve Cottons (të pambuktat) dhe Cotton Eco (program ekonomik për të pambuktat), ekranin tregon kohëzgjatjen e gjysmë ngarkesës, si rastin më të zakonshëm të përdorimit. Pas fillimit të programit, për 20-25 minuta lavatriça do të identifikojë ngarkesën aktuale. Dhe nëse ngarkesa e identifikuar është më e madhe se gjysma e ngarkesës; programi i larjes do të përshtatet dhe kohëzgjatja e programit do të rritet automatikisht. Këtë ndryshim mund ta ndiqni në ekran.

Paralarje	Larje e shpejt	Shpërlarje plotësuese	Heqja e Qimeve të Kafshëve	Mos rrudhosje	Metoda e Natës	Temperatura	Frotullim	Pa frotullime	Ftohtë	Shpërlarje e shtyrë
Shpërlarje e shtyrë	Larje e shpejt	Avull	Heqja e Qimeve të Kafshëve	Ftohtë	Tharje					


5 Përdorimi i produktit

5.1 Paneli i kontrollit



- 1 - Çelësi i zgjedhjes së programit
- 2 - Dritat e nivelit të temperaturës
- 3 - Dritat e nivelit të shpejtësisë së centrifugimit
- 4 - Ekran
- 5 - Butoni Nisje/Pushim
- 6 - Butoni i telekomandës
- 7 - Butoni i rregullimit të kohës së mbarimit
- 8 - Butoni i rregullimit të nivelit të tharjes
- 9 - Butoni i funksionit ndihmës 2
- 10 - Butoni i funksionit ndihmës 1
- 11 - Butoni i rregullimit të shpejtësisë së centrifugimit
- 12 - Butoni i rregullimit të temperaturës

5.2 Simbolet e ekranit



- a - Treguesi i temperaturës
- b - Treguesi i shpejtësisë së centrifugimit
- c - Informacione të kohëzgjatjes
- d - Simboli Kyçi i derës është aktivizuar
- e - Treguesi i vazhimit të programit
- f - Treguesi Nuk ka ujë
- g - Treguesi Shtoni robra
- h - Treguesi Lidhja Bluetooth
- i - Treguesi i telekomandës
- j - Simboli Nisja e vonuar është aktivizuar
- k - Treguesi i nivelit të ndotjes
- l - Simboli Kyçi për fëmijët është aktivizuar
- m - Treguesit e funksionit ndihmës 2
- n - Treguesit e funksionit ndihmës 1
- o - Treguesi Pa centrifugim
- p - Treguesi Mbaj në shpëlarje
- r - Treguesi Ujë i ftohtë

5.3 Përgatitja e lavatriçes

1. Kontrolloni që tubat të jenë lidhur mirë.
2. Vendoseni në prizë lavatriçen.
3. Hapeni rubinetin plotësisht.
4. Vendosini rrobat në lavatriçe.
5. Shtoni detergjent dhe zbutës rrobash.

5.4 Zgjedhja e programeve të larjes

1. Në përputhje me tabelën "Tabela e programeve dhe konsumit" zgjidhni programin e përshtatshëm për sasinë dhe nivelin e njollave të rrobave.
2. Zgjidhni programin e dëshiruar me çelësin **Zgjedhja e programit**.



INFORMACION

- Programet janë të kufizuara me shpejtësinë më të madhe të centrifugimit të përshtatshme për ato lloje të veçantë të pëlhurës.
- Kur zgjidhni një program, merrni gjithmonë parasysh llojin e materialit, ngjyrat, nivelin e ndotjes dhe temperaturën e lejuar të ujit.
- Zgjidhni gjithmonë temperaturën më të ulët të përshtatshme. Temperatura më e lartë do të thotë më shumë konsum energjie.

5.5 Programet e larjes

Në varësi të llojit të materialit, përdorni programet kryesore në vijim.



INFORMACION

- Pas zgjedhjes së një programi larës të përshtatshëm për rrobat tuaja, mund të shtypni butonin e tharjes për ta caktuar makinën që të kryejë tharjen pas programit të larjes. Çdo herë që shtypni butonin, rreshti i informacionit tregon se në cilin hap procesi i tharjes do të bëhet dhe simboli përkatës do të ndizet. Nëse dëshironi, mund të vazhdoni të shtypni butonin për të kryer tharje për periudhën maksimale të lejuar.
- Simbolet e shfaqura në ekran janë skematike dhe mund të mos përputhen saktësisht me produktin.
- Kur bëni larjen dhe tharjen duke përdorur funksionin e tharjes në lavatriçen tuaj, futni në lavatriçe maksimumi 5 kg rroba. Nëse tejkalon kapacitetin e lavatriçes, rrobat tuaja nuk do të thahen dhe lavatriça do të punojë më gjatë, gjë që do të rezultojë në konsum më të madh të energjisë.

• Cottons (Pambuk)

Mund të lani rrobat tuaja rezistente prej pambuku (çarçafë, mbulesa, peshqirë, rroba dushi, të brendshme, etj.) në këtë program. Kur shtypni butonin e funksionit të larjes së shpejtë, kohëzgjatja e programit bëhet dukshëm më e shkurtër por larja efikase garantohej në sajë të lëvizjeve intensive larëse. Nëse nuk zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë, garantohej një rendiment larjeje dhe shpëlarjeje superior për rrobat tuaja shumë të ndotura.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.

• Synthetics (Sintetike)

Mund ta përdorni këtë program për të larë bluza, pëlhuara të përziera sintetike/pambuku, etj. Kohëzgjatja e programit është dukshëm më e shkurtër, si dhe efikasiteti i rendimentit të larjes garantohej. Nëse nuk zgjidhet një rendiment larjeje dhe shpëlarjeje superior për rrobat tuaja shumë të ndotura.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.

• Woollens/Hand Wash (Të leshtat/Larje me dorë)

Përdorni këtë program për të larë rrobat tuaja të leshta. Zgjidhni temperaturën e duhur duke iu përmbytur etiketave të rrobave tuaja. Rrobat tuaja do të lahen me lëvizje shumë delikate për të shmangur ndonjë dëmtim.



INFORMACION

- Funksioni i tharjes nuk mund të zgjidhet në programin e larjes të përcaktuar për të leshtat.

• Cottons Eco (Pambuk Eco)

Përdoreni për të larë rrobat dhe ndërresat prej pambuku rezistues dhe me njolla normale. Megjithëse lan më gjatë se të gjitha programet e tjera, mundëson kursim të lartë të energjisë dhe të ujit. Temperatura e tanishme e ujit mund të jetë e ndryshme nga temperatura e treguar e larjes. Kur lani më pak sasi rrobash (p.sh. në gjysmën e kapacitetit ose më pak), kohëzgjatja e hapave të programit mund të bëhet automatikisht më e shkurtër. Në këtë rast, konsumi i energjisë dhe i ujit do të ulet akoma më shumë, duke siguruar një larje më ekonomike.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.

• Daily Express / Xpress Super Short (Larja ditore e shpejtë / Super e shkurtër)

Përdoreni këtë program për të larë për një kohë të shkurtër një sasi të vogël veshjesh prej pambuku pak të ndotura. Kohëzgjatja e programit mund të reduktohet deri në 14 minuta kur zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë. Kur zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë, mund të lahen deri në maksimumi 2 (dy) kg roba.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.

• Shirts (Këmishët)

Përdoreni këtë program për të larë këmishët prej pambuku, sintetike dhe pëlhurat e përziera sintetike së bashku. Ky program mundëson që rrobat tuaja të rrudhen më pak. Kur zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë, përdoret algoritmi i para-trajtimit.

- Aplikojeni lëndën kimike të para-trajtimit

direkt mbi rrobat tuaja ose shtojeni së bashku me detergjentin në ndarjen e detergjentit pluhur kur lavatriça fillon të marrë ujë. Në këtë mënyrë, do t'ju duhet më pak kohë për të marrë rendimentin që normalisht do ta merrnit me një cikël të rregullt larjeje. Jetëgjatësia e këmishëve do të jetë më e madhe.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.

• Down Wear (Xhupat)

Përdoreni këtë program për të larë palto, jelekë, xhaketa, etj. të cilat mbajnë etiketën "lahet në lavatriçe". Falë profileve të veçanta të centrifugimit, garantohet që uji të arrijë në boshllëqet e ajrit në mes të puplave.

• Downloaded Program (Programi i shkarkuar)

Ky është një program i veçantë që ju lejon të shkarkoni programe të ndryshme kur të doni. Në fillim, ekziston një program që do të shihni me aplikacionin HomeWhiz si parazgjedhje. Megjithatë, mund të përdorni aplikacionin HomeWhiz për të zgjedhur një program nga cilësimet e programeve të paracaktuara dhe pastaj ta ndryshoni atë.



INFORMACION

- Nëse dëshironi të përdorni funksionet HomeWhiz dhe Remote Control (telekomanda), duhet të zgjidhni Download Program (Shkarkoni Programin). Për më shumë detaje shihni seksionin HomeWhiz dhe funksionin e telekomandës.

• Të përziera

Mund ta përdorni këtë program për të larë pëlhurat prej pambuku dhe ato sintetike së bashku pa pasur nevojë t'i klasifikoni ato.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.

• Jashtë / Sporte

Përdoreni këtë program për të larë rrobat sportive që përmbajnë përzierje pambuku/sintetike, si dhe pëlhurat e papërshkueshme nga uji si gore-tex. Ky program i lan rrobat tuaja me delikatesë falë lëvizjeve të veçanta rrotulluese.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.

• Rinse (Shpëlarje)

Përdoreni kur doni të shpëlani ose të zbardhni veçmas.

• Spin+Drain (Centrifugim+Shkarkim)

Përdoreni këtë program për të shkarkuar ujin në lavatriçe.

5.6 Zgjedhja e temperaturës



Kurdoherë që zgjidhet një program i ri, temperatura e rekomanduar për programin shfaqet në treguesin e temperaturës. Është e mundur që temperatura e rekomanduar të mos jetë vlera më e lartë që mund të zgjidhet për programin përkatës. Shtypni butonin **Rregullimi i temperaturës** për të ndryshuar temperaturën.



INFORMACION

- Mund të thani rrobat pa ndërprerje menjëherë pas programit të larjes (është e mundur të kryeni tharje automatike ose të planifikuar pas ciklit të larjes). Për këtë, duhet të zgjidhni gjithashtu funksionin e tharjes para se të filloni programin e larjes.
- Sipas zgjedhjeve të tharjes që do t'i shtoni programeve të larjes, mund të shikoni kur do të mbarojë programi në ekranin e lavatriçes.
- Nëse nuk doni që të bëhet tharja pas programit që keni zgjedhur, shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës të tharjes derisa drita Drying (Tharje) të fiket.



INFORMACION

- Butoni i rregullimit të temperaturës punon vetëm mbrapsht. Për shembull, nëse ekrani tregon 40 °C, por ju dëshironi të zgjidhni 60 °C, do të duhet ta shtypni butonin disa herë, derisa të arrini 60 °C nga 40 °C.



INFORMACION

- Nëse shkoni në opsionin e larjes së ftohtë dhe shtypni përsëri butonin e rregullimit të temperaturës, temperatura maksimale e rekomanduar për programin e zgjedhur shfaqet në ekran. Për të ulur temperaturën, shtypni butonin e rregullimit të temperaturës.

Së fundi, drita e Ftohtë do të ndizet, duke treguar larjen e ftohtë.

Gjithashtu mund të ndryshoni temperaturën pasi të ketë filluar cikli i larjes. Mund të zgjidhni temperaturën e dëshiruar pasi të ketë filluar programi i larjes. Megjithatë, duhet ta zgjidhni atë përpara fillimit të hapit të ngrohjes.


• Të brendshme grash

Mund ta përdorni këtë program për të larë rrobat delikate që janë të përshtatshme për larje me dorë dhe të brendshmet delikate të grave. Sasitë e vogla të rrobave duhet të lahen në rretë larjeje. Çengelët, kopsat dhe zinxhirët duhet të mbyllen.

• Peshqir

Përdoreni këtë program për të larë rrobat e pambukta të qëndrueshme siç janë peshqirët. Futini peshqirët në lavatriçe duke bërë kujdes për t'i vendosur në atë mënyrë që të mos bien në kontakt me gomën e ajrit ose xhamin.

5.7 Zgjedhja e shpejtësisë të centrifugës



Sa herë që zgjidhet një program i ri, shpejtësia e centrifugës e rekomanduar për programin e zgjedhur shfaqet në treguesin **Spin Speed** (Shpejtësia e centrifugës).



INFORMACION

- Është e mundur që shpejtësia e rekomanduar e centrifugës të mos jetë vlera më e lartë që mund të zgjidhet për programin përkatës.

Shtypni butonin **Rregullim i shpejtësisë së centrifugës** për të ndryshuar shpejtësinë e centrifugës. Shpejtësia e centrifugës bie ngadalë. Pastaj, në varësi të modelit të produktit, opsionet "Mbaj në Shpëlarje" dhe "Pa rrotullim" shfaqen në ekran.



INFORMACION

- Butoni i rregullimit të shpejtësisë së centrifugës punon vetëm mbrapsht. Për shembull, nëse ekrani tregon 800 rpm, por ju dëshironi të zgjidhni 1000 rpm, do të duhet të shtypni butonin disa herë derisa të arrini 1000 rpm nga 800 rpm.

5.7.1 Nëse doni të centrifugoni rrobat pas funksionit Rinse Hold (Mbaj në Shpëlarje):

- Rregulloni **Shpejtësinë e centrifugës**.
- Shtypni butonin **Start/Pause**. Programi do të vazhdojë. Lavatriçja do të thajë ujin dhe do të rrotullojë rrobat. Nëse doni t'i kulloni rrobat në fund të programit pa bërë centrifugim, mund të përdorni funksionin **Pa Centrifugim**.



INFORMACION

- Nëse shtypni butonin e rregullimit të shpejtësisë së centrifugës në programet ku shpejtësia e centrifugës nuk lejohet, cilësimi i shpejtësisë së centrifugës nuk do të ndryshojë dhe do të dëgjoni një mesazh paralajmërues.

Gjithashtu mund të ndryshoni shpejtësinë e centrifugës pasi të ketë filluar cikli i larjes. Pasi të ketë përfunduar cikli i larjes, mund të shtypni butonin e rregullimit të shpejtësisë së centrifugës për ta zgjedhur shpejtësinë e centrifugës. Megjithatë, duhet ta zgjidhni atë përpara fillimit të hapit të centrifugimit.

5.7.2 Zgjedhja e funksionit ndihmës për tharje



Kur zgjidhni një program të ri larjeje, shtypni butonin e zgjedhjes së funksionit ndihmës për të caktuar opsionin e tharjes të përshtatshëm për këtë program.



INFORMACION

- Nëse shtypni butonin e funksionit ndihmës të tharjes në programet ku hapi i tharjes nuk lejohet, drita e tharjes nuk do të ndryshojë dhe do të dëgjoni një mesazh paralajmërues.



INFORMACION

- Vetëm për programet e tharjes, shtypni butonin e zgjedhjes së funksionit ndihmës për të caktuar opsionin e përshtatshëm të tharjes.

5.8 Programet e tharjes



KUJDES!

- Gjatë programit të tharjes, lavatriçja i heq automatikisht fijet që dalin nga rrobat. Lavatriçja përdor ujë në hapin e tharjes. Për këtë arsye, çezma e ujit të lavatriçës duhet të jetë e hapur edhe në programet e tharjes.
- Kur zgjidhni një program të ri larjeje, shtypni butonin e zgjedhjes së funksionit ndihmës për të caktuar opsionin e tharjes të përshtatshëm për këtë program.



INFORMACION

- Ka gjithashtu një hap centrifugimi në programet e tharjes. Lavatriçja juaj e bën këtë proces me qëllim që të shkurttojë kohën e tharjes. Ndërsa zgjidhet programi i tharjes, cilësimi i shpejtësisë së centrifugës është brenda intervalit të shpejtësisë maksimale të centrifugës.
- Nëse shtypni butonin e funksionit ndihmës të tharjes në programet ku hapi i tharjes nuk lejohet, drita e tharjes nuk do të ndryshojë dhe do të dëgjoni një mesazh paralajmërues.
- Vetëm për programet e tharjes, shtypni butonin e zgjedhjes së funksionit ndihmës për të caktuar opsionin e përshtatshëm të tharjes.
- Në rast të ndërprerjes së ujit, larja ose tharja nuk mund të kryhet.

• Synthetic Dry (Tharje e Sintetikeve)

Përdoreni këtë program për të tharë rroba sintetike me peshë të thatë deri në 3 kg. Në këtë program mund të kryhet vetëm tharje.



INFORMACION

- Për peshat e thata të rrobave, shikoni Pjesën 4, Hapi 4.5.

• Cotton Dry (Tharje Pambuku)

Përdoreni këtë program për të tharë rroba pambuku me peshë të thatë deri në 4 kg. Në këtë program mund të kryhet vetëm tharje.



INFORMACION

- Nëse do të thani rroba që përfshijnë vetëm peshqirë dhe rroba banje, shuma maksimale e rrobave që mund të ngarkohet është 4 kg.
- Për peshat e thata të rrobave, shikoni Pjesën 4, Hapi 4.5.


• 4 Kg Wash & Dry (Larje dhe tharje 4 kg)

Përdoreni për të larë rroba pambuku deri në 4 kg dhe për t'i tharë menjëherë pas programit të larjes pa bërë asnjë zgjedhje tjetër.



INFORMACION

- Kur zgjidhet ky program, funksioni i jashtëm ndihmës i tharjes nuk mund të zgjidhet.



Në programin e larjes 4 kg dhe atë të tharjes 4 kg, rekomandohet që ta ngarkoni lavatriçen deri në nivelin e treguar më sipër për kushtet ideale të tharjes (mund të shihni shigjetën e nivelit nëse hapni derën e ngarkimit).

• Wash & Wear (Laj dhe vish)

Përdoreni këtë program për të larë 0,5 kg rroba (2 këmisha) në 40 minuta ose 1 kg rroba (5 këmisha) në 60 minuta.



INFORMACION

- Programi Wash&Wear (Laj dhe Vish) është bërë për të larë dhe tharë shpejt rrobat e përditshme që janë veshur për një kohë të shkurtër dhe nuk janë ndotur shumë. Ky program është i përshtatshëm për rroba me përbërje të hollë, të cilat thahen shpejt (këmisha, bluza).
- Opsionet ose programet e tjera të tharjes duhet të përdoren për rrobat me përbërje të trashë të cilat duan më shumë kohë të thahen.

5.9 Programet e larjes dhe të tharjes



KUJDESI!

- Gjatë programit të tharjes, lavatriçja i heq automatikisht fijet që dalin nga rrobat. Lavatriçja përdor ujë në hapin e tharjes. Për këtë arsye, çezma e ujit të lavatriçës duhet të jetë e hapur edhe në programet e tharjes.

• Hygiene+ Wash & Dry (Larje dhe tharje anti-alerjike)

Aplikimi i një faze me avull në fillim të programit mundëson zbutjen e ndotjes lehtësisht. Përdoreni këtë program për të larë dhe tharë shpejt rroba (deri në 2 kg) që duhet të lahen në mënyrë higjienike dhe anti-alerjike (pëlhurat e pambukut të tilla si rrobat e foshnjës, çarçafët dhe të brendshmet).



INFORMACION

- Programi Anti Allergy (Anti Alergj) është testuar dhe aprovuar nga "The British Allergy Foundation" (Allergy UK) në Mbretërinë e Bashkuar.

5.10 Tabela e programeve dhe e konsumit (për larje)

SQ						Funksione Ndhmëse					
Programi (°C)		Ngarkesa Maksimale (kg)	Konsumi i Ujit (l)	Konsumi i Energjisë (kiloat-orë)	Shpejtësia maks. ***	Paralarje	E shpejtë+	Avull	Anti-Rrudhë+	Tharje	Shtrirja e temperaturës të zgjedhur °C
Cottons	90	7	94	2,30	1400	•	•	•	•	•	Ftohtë - 90
	60	7	94	1,70	1400	•	•	•	•	•	Ftohtë - 90
	40	7	92	0,95	1400	•	•	•	•	•	Ftohtë - 90
Cottons Eco	60**	7	45	0,800	1400					•	Ftohtë - 60
Synthetics	60	3	65	1,20	1200	•	•	•	•	•	Ftohtë - 60
	40	3	63	0,85	1200	•	•	•	•	•	Ftohtë - 60
Daily Express / Xpress Super Short	90	7	66	2,15	1400		•	•	•	•	Ftohtë - 90
	60	7	66	1,15	1400		•	•	•	•	Ftohtë - 90
	30	7	66	0,20	1400		•	•	•	•	Ftohtë - 90
Daily Express / Xpress Super Short+E shpejtë+	30	2	39	0,15	1400		•	•	•	•	Ftohtë - 90
Woollens / Hand Wash	40	1,5	53	0,50	1200						Ftohtë - 40
Down Wear	60	1,5	75	1,20	1000			•			Ftohtë - 60
Shirts	60	3	57	1,20	800	•	•	•	•	•	Ftohtë - 60
Pastrimi i kazanit+	90	-	77	2,30	600			*		*	90
Downloaded Program (Programi i shkarkuar) *****											
Të përziera (Mix)	40	3	68	0,75	800	•	•	•	•	•	Ftohtë - 40
Jashtë / Sporte	40	3	51	0,45	1200	•				•	Ftohtë - 40
Të errëta / Xhinse	40	3	75	0,80	1200	•	•	•	•	•	Ftohtë - 40
Peshqir	60	1,5	75	1,20	1000			•			Ftohtë - 60
Të brendshme grash	30	1	70	0,30	600						Ftohtë - 30

• : Mund të zgjidhet.

* : Zgjidhet automatikisht, nuk mund të anulohet.

** : Programi i klasifikimit të energjisë (EN 50229)

***: Nëse shpejtësia maksimale e centrifugimit të lavatriçes është më e ulët, mund të zgjidhni vlerat deri në vlerën maksimale të shpejtësisë së centrifugimit.

****: Këto programe mund të përdoren me aplikacionin HomeWhiz.

- : Shikoni përshkrimin e programit për ngarkesën maksimale.



INFORMACION

- Funksionet ndihmëse në tabelë mund të variojnë sipas modelit të lavatриçes tuaj.
- Konsumi i ujit dhe i energjisë mund të variojë si pasojë e ndryshimeve në presionin e ujit, fortësisë së ujit dhe temperaturës, temperaturës së mjedisit, llojit dhe sasisë së rrobave, zgjedhjes së funksioneve ndihmëse dhe shpejtësisë së centrifugimit, si dhe ndryshimeve në tensionin e rrjetit.
- Ndërsa zgjidhni një program, mund të shikoni kohëzgjatjen e larjes në ekranin e lavatриçes. Në varësi të sasisë së rrobave që keni futur në lavatриçe, mund të ketë një ndryshim prej 1 deri 1,5 orësh midis kohëzgjatjes së shfaqur në ekran dhe kohëzgjatjes reale të programit të larjes. Kohëzgjatja do të korrigjohet automatikisht menjëherë pas fillimit të programit të larjes.
- "Modalitetet e zgjedhjes së funksioneve ndihmëse mund të ndryshohen nga kompania e prodhimit. Mund të shtohen modalitete të tjera të zgjedhjes ose mund të hiqen ato ekzistuese."
- "Shpejtësia e centrifugimit të lavatриçes tuaj mund të ndryshojë në varësi të programit; shpejtësia e centrifugimit nuk mund ta tejkalojë shpejtësinë maksimale të centrifugimit të lavatриçes suaj."

Tabela e programeve dhe e konsumit (për tharje)

SQ						Funksione Ndhmëse					Niveli i tharjes				
						Paralarje	E shpejtë+	Avull	Anti-Rrudhë+	Tharje	Tharje ekstra	Tharje për Dollap	Tharje për Hekurosje	Tharje me kohë	Shtirirja e temperaturës të zgjedhur °C
Programi (°C)		Ngarkesa Maksimale (kg)	Konsumi i Ujit (l)	Konsumi i Energjisë (kilovat-orë)	Shpejtësia maks.***										
Cotton Dry	-	4	45	3,20	1400				•	*	•	•	•	•	-
Synthetic Dry	-	3	30	2,40	-				•	*		•	•	•	-
Hygiene+ Wash & Dry	60	2	125	4,00	1400			*	•	*	•	•	•	•	90-30
4 Kg Wash & Dry	60	4	75	4,20	1400				•	*	•	•	•	•	60-Ftohtë
Wash & Wear	30	0,5	30	0,60	1000				•	*				•	30-Ftohtë
Wash & Wear	30	1	40	1,00	1000				•	*				•	30-Ftohtë



INFORMACION


Informacione për udhëzimet e testimit:

"Testet e rendimentit të larjes për emërtimin e energjisë në BE janë bërë në programin "Pambuk Eko 60°C" sipas standardit EN 50229.

Sipas standardit EN 50229 për sistemin e BE-së për etiketimin e energjisë në rendimentin e tharjes, ngarkesa maksimale e larjes duhet të ndahet në grupe, si kapaciteti maksimal i tharjes dhe kapaciteti i mbetur i tharjes, dhe secila ngarkesë duhet të thahet duke përdorur opsionin "Tharje pambuku tharje ekstra".

5.11 Zgjedhja e funksioneve ndihmëse

Përzgjidhni funksionet e dëshiruara ndihmëse para se të nisni programin. Kur zgjidhet një program, dritat e funksioneve ndihmëse që mund të zgjidhen së bashku me atë program do të ndizen.



INFORMACION

- Dritat e funksioneve ndihmëse që nuk mund të zgjidhen së bashku me programin e zgjedhur nuk do të ndizen. Nëse shtypni butonat e këtyre funksioneve ndihmëse, do të dëgjoni një mesazh paralajmërues dhe përzgjedhja do të çaktivizohet.

Nëse programi i larjes ka arritur një pikë ku nuk mund të zgjidhni funksionin ndihmës, funksioni nuk mund të zgjidhet.



INFORMACION

- Disa funksione nuk mund të përzgjidhen së bashku. Nëse një funksion i dytë ndihmës që bie në konflikt me të parin përzgjidhet para vënies në punë të pajisjes, funksioni i përzgjedhur i pari do të anulohet dhe funksioni i dytë ndihmës do të mbetet aktiv.
- Nuk mund të përzgjidhet një funksion ndihmës që nuk përputhet me programin. (Shikoni "Tabela e programeve dhe e konsumit".)
- Disa programe kanë funksione ndihmëse që duhen përdorur me programin e zgjedhur. Këto funksione nuk mund të anulohen. Drita e funksionit përkatës ndihmës është tashmë aktive.



INFORMACION

- Nëse niveli i lagështisë së përzgjedhur (Tharje me hekur, Tharje për dollap, Tharje ekstra për dollap) nuk mund të arrihet në fund të programit të tharjes, lavatriçja do ta zgjatë automatikisht kohëzgjatjen e programit. Programi do të zgjasë më shumë.
- Nëse zgjidhet tharja me kohë, programi do të mbarojë në fund të kohës së parashikuar edhe nëse rrobat nuk janë të thata.
- Nëse, gjatë programit të tharjes, arrihet niveli i zgjedhur i lagështisë (Tharje me hekur, Tharje për dollap, Tharje ekstra për dollap), ose identifikohet tharje ekstra në opsionet e tharjes me kohë, programi do të zgjatë më pak. Ulja e kohës do të shfaqet në ekran.

5.11.1 Funksionet ndihmëse

• Paralarje

Paralarja kërkohet vetëm për rroba shumë të ndotura. Mospërdorimi i Paralarjes do të kursejë energji, ujë, detergjent dhe kohë.

• E shpejtë+

Mund të shtypni butonin e cilësimit të larjes së shpejtë për të shkurtuar kohëzgjatjen e programit pas zgjedhjes së një programi. Për disa programe, koha mund të shkurtohet me mbi 50%. Megjithatë, për rrobat me ndotje mesatare apo të lehtë, do të merrni të njëjtat rezultate të larjes në një kohë më të shkurtër. Megjithëse varet nga programi, shtypja e butonit të larjes së shpejtë një herë, do të shkurttojë kohën e programit deri në një nivel të caktuar. Shtypni të njëjtin butonin për herë të dytë për ta lënë kohën në nivelin minimal. Për rezultate më të mira të larjes, mos e përdorni butonin e larjes së shpejtë për rrobat shumë të ndotura. Për larje rrobash me ndotje mesatare dhe të lehta, përdorni butonin e larjes së shpejtë për të shkurtuar kohën e programit.

• Telekomanda

Mund ta përdorni këtë buton funksioni ndihmës për të lidhur pajisjen tuaj me pajisje inteligjente. Informacione të hollësishme mund të gjenden në Funksioni HomeWhiz dhe funksioni i telekomandës.

• Programi i personalizuar

Ky funksion ndihmës mund të përdoret vetëm për programet e pambukut dhe sintetiëve me aplikacionin HomeWhiz. Kur ky funksion ndihmës aktivizohet, mund të shtoni deri në 4 hapa shtesë të shpëlarjes në program. Mund të zgjidhni dhe përdorni disa funksione ndihmëse edhe pse ato nuk gjenden në pajisjen tuaj. Mund të rrisni dhe ulni kohën e programeve të pambukut dhe sintetiëve brenda një intervali të sigurt.

• Tharje

Ky funksion than rrobat tuaja pas ciklit të larjes. Ju lutemi të shihni tabelën e programeve për programet që mund të përdoren me këtë funksion.

5.11.2 Funksionet/programet e zgjedhura duke shtypur butonat e funksioneve për 3 sekonda

• Pastrimi i kazanit 3"

Për të zgjedhur programin, shtypni dhe mbani shtypur butonin 1 të funksionit ndihmës për 3 sekonda. Përdoreni rregullisht (një herë në çdo 1-2 muaj) për të pastruar kazanin dhe për të siguruar higjienën e kërkuar. Aplikohet avulli para programit për të zbutur mbetjet në kazan. Vëreni programin në punë kur pajisja të jetë komplet bosh. Për të arritur rezultate më të mira, vendosni antikalkar për lavatriçe në ndarjen e detergjentit nr. "2". Ky program ka një hap tharjeje që vihet në punë pas hapit të pastrimit të kazanit për të tharë pjesën e brendshme të pajisjes.



INFORMACION

- Ky nuk është një program larjeje. Është një program mirëmbajtjeje.
- Mos e vini programin në punë kur ka objekte në lavatriçe. Nëse përpiqeni të bëni këtë, pajisja do të dallojë që ka ngarkesë brenda dhe do ta ndërpresë programin.

• Anti-Rrudhë 3"

Nëse shtypni dhe mbani shtypur butonin e përzgjedhjes së shtrydhjes për 3 sekonda, ky funksion do të zgjidhet dhe drita pasuese e programit përkatës do të ndizet. Kur zgjidhet ky funksion, rrobat ajrosen për deri në 8 orë në fund të programit për të parandaluar rrudhat. Mund ta anuloni programin dhe t'i nixirni rrobat në çdo kohe gjatë periudhës 8-orëshe. Shtypni butonin e zgjedhjes së funksionit ose butonin aktiv/joaktiv të pajisjes për ta anuluar funksionin. Drita pasuese e programit do të qëndrojë ndezur derisa të anulohet funksioni ose të mbarojë hapi. Nëse funksioni nuk mund të anulohet, ai do të jetë aktiv edhe në ciklet e larjeve të mëvonshme.

• Avull 3"

Mund të shtypni dhe mbani shtypur butonin 2 të funksionit ndihmës për 3 sekonda, për të zgjedhur këtë funksion. Përdoreni këtë program për të zvogëluar rrudhat dhe për të shkurtuar kohën e hekurosjes për një sasi të vogël rrobash pambuku, sintetiëve ose të përziera që nuk janë njolllosur.

• Kyçi për fëmijët 3"

Përdorni funksionin e Kyçit për fëmijët për të mos i lejuar ata të ngacmojnë pajisjen. Kështu mund të shmangni ndonjë ndryshim të programit që është në punë.



INFORMACION

- Kur Kyçi për fëmijët është aktivizuar, mund të shtypni butonin On/Off për të ndezur ose fikur lavatriçen. Programi rifillon kur e nisni përsëri lavatriçen.
- Do të dëgjoni një paralajmërim nëse butonat shtypen kur është aktivizuar Kyçi për fëmijët. Ky paralajmërim i dëgjueshëm do të anulohet nëse butonat shtypen pesë herë me radhë.

Për të aktivizuar Kyçin për fëmijët Shtypni dhe mbani shtypur butonin Rregullimi i nivelit të tharjes për 3 sekonda. Kur përfundon numërimi **"CL 3-2-1"** në ekran, do të shfaqet ikona **"CL On"** (Kyçi për fëmijët aktiv). Sapo të shihni këtë paralajmërim, mund të lëshoni **butonin e rregullimit të nivelit të tharjes**.

Për të çaktivizuar Kyçin për fëmijët:
Shtypni dhe mbani shtypur butonin Rregullimi i nivelit të tharjes për 3 sekonda. Kur përfundon numërimi **"CL 3-2-1"** në ekran, do të shfaqet ikona **"CL Off"** (Kyçi për fëmijët joaktiv).

• Bluetooth

Mund të përdorni funksionin e lidhjes Bluetooth për të çiftuar lavatriçen tuaj me pajisjen tuaj inteligjente. Në këtë mënyrë, mund të përdorni pajisjen tuaj inteligjente për të marrë informacion në lidhje me lavatriçen tuaj dhe ta komandoni atë.

Për të aktivizuar Bluetooth:

Shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit të telekomandës për 3 sekonda. Do të shihni numërimin **"3-2-1"**, dhe do të shfaqet simboli **"On"**. Lëshoni **butonin e funksionit të telekomandës**. Ikona e Bluetooth do të pulsojë ndërsa produkti po lidhet me pajisjen inteligjente. Nëse lidhja është e suksesshme, drita e ikonës do të mbetet e ndezur.

Për të çaktivizuar Bluetooth:

Shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit të telekomandës për 3 sekonda. Do të shihni numërimin **"3-2-1"**, dhe do të shfaqet simboli **"Off"**.



INFORMACION

- Duhet të përfundoni konfigurimin e parë të aplikacionit HomeWhiz, që të aktivizohet Bluetooth. Pas konfigurimit, nëse shtypni butonin e funksionit të telekomandës kur butoni është në pozicionin Shkarkimi i programit/Telekomanda, lidhja Bluetooth do të aktivizohet automatikisht.

5.12 Hapat e Tharjes



5.12.1 Tharje për Hekurosje

Tharja vazhdon derisa niveli i tharjes të arrijë hapin Tharje për Hekurosje.

5.12.2 Tharje për Dollap

Tharja vazhdon derisa niveli i tharjes të arrijë hapin Tharje për Dollap.

5.12.3 Tharje ekstra

Tharja vazhdon derisa niveli i tharjes të arrijë hapin Tharje ekstra.



INFORMACION

- Niveli i thatësisë mund të ndryshojë në varësi të përzierjes së rrobave, llojit të materialit, sasisë dhe nivelit të lagështisë së rrobave.
- Mos e përdorni lavatriçen për të tharë rroba që përmbajnë dantellë, tyl, gurë të çmuar, rruaza, xhixha, tela, etj., ose rroba me përmbajtje të lartë mëndafshi.

5.12.4 Tharje me kohë

Mund të zgjidhni 30, 90 ose 150 minuta tharje për të arritur nivelin e dëshiruar të thatësisë në një temperaturë të ulët.



INFORMACION

- Kur thani sasi të vogla rrobash (2 copa maksimumi), zgjidhni hapat e tharjes me kohë në programet e tharjes Cottons ose Synthetics (Pambuk ose Sintetike).
- Nëse rrobat nuk kanë arritur në nivelin e dëshiruar të tharjes në fund të programit të tharjes, mund të zgjidhni tharjen me kohë për të mbaruar procesin.
- Kur zgjidhet ky funksion, lavatriça e kryen tharjen për kohën e vendosur pavarësisht nga niveli i tharjes.

5.13 Shfaqja e kohës


Ndërsa programi është në funksion, koha e mbetur deri në fund të programit do të shfaqet në orë dhe minuta, p.sh. "01:30".



INFORMACION

- Koha e programit mund të jetë e ndryshme nga vlerat në tabelën "Tabela e programeve dhe konsumit" në varësi të presionit të ujit, kripërave dhe temperaturës së ujit, temperaturës së ambientit, sasisë dhe llojit të rrobave, funksioneve ndihmëse të zgjedhura dhe luhatjeve të tensionit.

5.14 Koha e mbarimit



Me funksionin **End Time** (Koha e mbarimit), nisja e programit mund të shtyhet deri në 24 orë. Pasi të keni shtypur butonin **Koha e mbarimit**, do të shfaqet koha e parashikuar e programit. Nëse vendoset **Koha e mbarimit**, drita **Koha e mbarimit** do të ndizet.

Për t'u siguruar që funksioni Koha e mbarimit të jetë aktivizuar dhe programi të mbarojë në fund të kohëzgjatjes së përcaktuar, duhet të shtypni **Start / Pause** pas vendosjes së kohëzgjatjes. Butoni **Start/Pause** do të pulsojë dhe do të mbetet i ndezur.

Nëse doni ta anuloni funksionin Koha e mbarimit, shtypni butonin **End Time** (Koha e mbarimit) derisa drita e kohës së mbarimit të fiket ose shtypni butonin **On/Off** për ta fikur dhe ndezur lavatriçen.

1. Hapeni derën e ngarkimit, vendosni rrobat dhe shtoni detergjent, etj.
2. Zgjidhni programin e larjes, temperaturën, shpejtësinë e centrifugës, nëse kërkohet, dhe funksionet ndihmëse.
3. Shtypni butonin **Koha e mbarimit** për të vendosur kohën e dëshiruar të mbarimit. Drita **Koha e mbarimit** do të ndizet.
4. Shtypni butonin **Start / Pause**. Fillon numërimi mbrapsht i kohës. Shenja ":" në mes të kohës së mbarimit në ekran fillon të pulsojë.



INFORMACION

- Mos përdorni detergjentë të lëngshëm kur aktivizoni funksionin End Time (Koha e mbarimit)! Mund të mbesin njolla në rroba.
- Dera qëndron e kyçur gjatë periudhës së numërimit mbrapsht të Kohës së mbarimit. Nëse dëshironi ta zhblokonti derën, shtypni butonin Start/Pause për ta kaluar lavatriçen në modalitetin e pushimit. Në fund të numërimit mbrapsht, treguesi i Kohës së mbarimit fiket, cikli i larjes fillon dhe koha e programit të zgjedhur shfaqet në ekran.
- Kur zgjidhet Koha e mbarimit, koha e shfaqur në ekran përbëhet nga koha e mbarimit plus kohëzgjatja e programit të zgjedhur.

5.15 Nisja e programit



1. Shtypni butonin **Start/Pause** për të filluar programin.
2. Drita pulsuese e butonit **Start/Pause** do të mbetet e ndezur, duke treguar se programi ka filluar.
3. Dera e ngarkimit do të kyçet. Kur dera është duke u kyçur, do të shfaqet paralajmërimi "Kyçja e derës".

5.16 Kyçja e derës së ngarkimit



Ka një sistem kyçjeje në derën e ngarkimit të lavatriçes që parandalon hapjen e derës së ngarkimit në rastet kur niveli i ujit është i papërshtatshëm për të hapur derën. Drita "Loading door locked" (Dera e ngarkimit e kyçur) në panel ndizet kur dera e ngarkimit është e kyçur.



INFORMACION

- Nëse zgjidhet funksioni i telekomandës, dera do të kyçet. Për të hapur derën, duhet të shtypni tastin e telekomandës ose të ndryshoni pozicionin e programit për të çaktivizuar funksionin e telekomandës.

Hapja e derës në rast të ikjes së korrentit:




INFORMACION

- Në rast të ikjes së korrentit, mund të përdorni dorezën e emergjencës së derës nën kapakun e filtrit të pompës për të hapur me dorë derën e ngarkimit.




PARALAJMËRIMI!

- Përpára se të hapni derën e ngarkimit, sigurohuni që nuk ka mbetur ujë brenda pajisjes për të shmangur çdo rrjedhje uji.



- Hapni kapakun e filtrit të pompës.




- Lëshoni dorezën e emergjencës së derës në anën e pasme të kapakut të filtrit.
- Tërhiqeni dorezën e emergjencës së derës së ngarkimit dhe hapeni këtë të fundit. Pas hapjes së derës, kthejeni dorezën emergjente në pozicionin e saj fillestar.
- Nëse nuk mund të hapni derën e ngarkimit, provoni përsëri duke tërhequr poshtë dorezën.

5.17 Ndryshimi i përzgjedhjeve pasi ka filluar programi

5.17.1 Shtimi i robave pasi ka filluar programi

Kur shtypni butonin **Start/Pause**, drita "Loading door locked" (Dera e ngarkimit e kyçur) në panel fiket nëse niveli i ujit në lavatriçe është i përshtatshëm.



Nëse niveli i ujit në lavatriçe nuk është i përshtatshëm kur shtypni butonin **Start/Pause**, paneli do t'ju paralajmërojë që dera e ngarkimit është e kyçur.



5.17.2 Kalimi i lavatriçes në mënyrën e pushimit:



Shtypni butonin **Start/Pause** për ta kaluar pajisjen në gjendje pauze.

5.17.3 Ndryshimi i zgjedhjes së programit pasi ka filluar programi:

Nëse Kyçi për fëmijët nuk është i aktivizuar, mund të ndryshoni programin ndërsa programi i tanishëm është në punë e sipër. Kjo do të anulojë programin aktual.



INFORMACION

- Programi i ri i përzgjedhur do të fillojë nga e para.

5.17.4 Ndryshimi i funksionit ndihmës, parametrave të shpejtësisë dhe temperaturës


Në varësi të hapit ku ka arritur programi, mund të anuloni ose zgjidhni funksionet ndihmëse. Shikoni "Zgjedhja e funksioneve ndihmëse" Gjithashtu mund të ndryshoni shpejtësinë e centrifugës, temperaturën dhe parametrat e tharjes. Shikoni, "Zgjedhja e shpejtësisë së centrifugës" dhe "Zgjedhja e temperaturës".



INFORMACION

- Nëse temperatura e ujit në lavatriçe është e lartë ose niveli i ujit është mbi nivelin e hapjes së derës, dera e ngarkimit nuk hapet.

5.18 Anulimi i programit



Programi do të anulohet nëse çelësi i përzgjedhjes së programit ndërrohet në një program tjetër ose nëse lavatriçja fiket dhe ndizet me këtë buton.



INFORMACION

- Programi nuk do të anulohet nëse e rrotulloni çelësin e përzgjedhjes së programit ndërkohë që Kyçi për fëmijët është i aktivizuar. Më parë duhet të anuloni Kyçin për fëmijët.
- Nëse doni ta hapni derën e ngarkimit pasi keni anuluar programin por nuk mund ta hapni meqenëse niveli i ujit në lavatriçe është mbi nivelin e hapjes së derës së ngarkimit, rrotullojeni çelësin e përzgjedhjes së programit në Pompë+Centrifugë dhe zbrazeni ujin në lavatriçe.

5.19 Mbarimi i programit

Sapo të përfundojë programi, do të shfaqet simboli i mbarimit.

Nëse nuk shtypni asnjë buton për 10 minuta, lavatriça do të kalojë në modalitetin joaktiv.

Ekrani dhe të gjithë treguesit fiken.

Nëse shtypni një buton çfarëdo, hapat e përfunduar të programit do të shfaqen.

5.20 Lavatriça juaj është në funksionin "Modaliteti i pushimit".

Pas përdorimit të butonit On/Off për të ndezur pajisjen, nëse nuk filloni ndonjë program në hapin e përzgjedhjes ose nuk bëni ndonjë gjë tjetër, ose nëse nuk bëni asgjë në 2 minuta pas përfundimit të programit të zgjedhur, programi do të kalojë automatikisht në modalitetin e kursimit të energjisë. Gjithashtu, nëse produkti juaj ka një ekran që tregon kohën e programit, ekrani do të fiket plotësisht. Nëse rrotulloni çelësin e programeve ose prekni një buton çfarëdo, dritat do të kthehen përsëri në pozicionin e mëparshëm. Zgjedhjet që bëni kur dilni nga modaliteti i efikasitetit të energjisë mund të ndryshojnë. Kontrolloni nëse zgjedhjet që keni bërë janë mirë para se të filloni programin. Nëse është e nevojshme, rregullojini sërish. Ky nuk është një gabim.

5.21 Funksioni HomeWhiz dhe funksioni i telekomandës

HomeWhiz ju lejon ta përdorni pajisjen tuaj inteligjente për të kontrolluar lavatriçen dhe për të marrë informacione lidhur me të. Falë aplikacionit HomeWhiz mund ta përdorni pajisjen tuaj inteligjente për të kryer disa procedura që mund të kryhen edhe në lavatriçe. Plus, mund të përdorni disa funksione vetëm me funksionin HomeWhiz.

Për ta përdorur funksionin Bluetooth në lavatriçen tuaj, duhet ta shkarkoni aplikacionin HomeWhiz nga dyqani i aplikacioneve të pajisjes suaj inteligjente. Sigurohuni që pajisja juaj inteligjente të jetë lidhur me internetin për të instaluar aplikacionin. Nëse po e përdorni aplikacionin për herë të parë, ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar procedurën e regjistrimit të përdoruesit. Sapo të përfundojë procedura e regjistrimit, mund t'i përdorni të gjithë produktet e shtëpisë tuaj me funksionin HomeWhiz, me këtë llogari. Në aplikacionin HomeWhiz, mund të prekni funksionin "Shto/Hiq pajisjen" për të parë produktet e lidhura me llogarinë tuaj. Mund t'i çiftoni këto produkte në këtë faqe.



INFORMACION

- Për të përdorur funksionin HomeWhiz, sigurohuni që aplikacioni të jetë i instaluar në pajisjen tuaj inteligjente dhe që lavatriça të jetë çiftuar me pajisjen tuaj inteligjente nëpërmjet funksionit Bluetooth. Nëse lavatriça nuk është çiftuar me pajisjen tuaj inteligjente, do të funksionojë si një pajisje që nuk e ka veçorinë HomeWhiz.
- Produkti juaj do të funksionojë sapo të çiftohet me pajisjen tuaj inteligjente nëpërmjet Bluetooth. Kontrollat e bëra nga aplikacioni do të aktivizohen nëpërmjet këtij çiftimi. Për këtë arsye, sinjali Bluetooth ndërmjet produktit dhe pajisjes inteligjente duhet të jetë mjaft i fortë.
- Ju lutemi të vizitoni www.homewhiz.com për të parë versionet Android dhe iOS të mundësuar nga aplikacioni HomeWhiz.



PARALAJMËRIM!

- Të gjitha masat e sigurisë të përshkruara në pjesën **"UDHËZIMET E PËRGJITHSHME TË SIGURISË"** të manualit tuaj të përdorimit zbatohen edhe për funksionimin e telekomandës përmes funksionit HomeWhiz.

5.21.1 Konfigurimi i HomeWhiz

Produkti dhe aplikacioni HomeWhiz duhet të jenë të lidhur në mënyrë që aplikacioni të funksionojë. Për ta vendosur këtë lidhje, ju lutemi të ndiqni hapat e mëposhtëm për konfigurimin si në produktin tuaj ashtu edhe në aplikacionin HomeWhiz.

- Nëse po shtoni një pajisje për herë të parë, prekni "Shto/Hiq pajisjen" në aplikacionin HomeWhiz. Pastaj prekni "Prekni këtu për të instaluar pajisjen e re". Ndiqni hapat e mëposhtëm si dhe udhëzimet në aplikacionin HomeWhiz për të përfunduar konfigurimin.
- Për të filluar konfigurimin, sigurohuni që lavatriçja juaj të jetë e fikur. Shtypni dhe mbani shtypur butonin e temperaturës dhe butonin e telekomandës në të njëjtën kohë për 3 sekonda, për të kaluar lavatriçen në modalitetin e konfigurimit HomeWhiz.



- Kur pajisja është në modalitetin e konfigurimit HomeWhiz, do të shihni një animacion në ekran dhe ikona Bluetooth do të pulsojë derisa lavatriçja të çiftohet me pajisjen tuaj inteligjente. Në këtë modalitet, aktivizohet vetëm butoni i programit. Butonat e tjerë janë të çaktivizuar.



- Në ekranin që shihni në aplikacion, zgjidhni lavatriçen e dëshiruar dhe shtypni Vazhdo.
- Vazhdoni të ndiqni udhëzimet në ekran derisa aplikacioni HomeWhiz t'ju kërkojë për produktin që dëshironi të lidhni me pajisjen tuaj inteligjente.
- Nëse lavatriçja çiftohet me pajisjen tuaj me sukses, ekranin do të ndizet automatikisht, funksioni Bluetooth do të mbetet i ndezur dhe do të dëgjoni një melodi që tregon se konfigurimi në pajisje ka qenë i suksesshëm.
- Ktheshuni në aplikacionin HomeWhiz dhe prisni derisa të përfundojë konfigurimi. Kur konfigurimi të ketë përfunduar, caktojini një emër lavatriçes suaj. Mund të prekni ekranin për të parë produktin që keni shtuar në aplikacionin HomeWhiz.



INFORMACION

- Nëse nuk mund ta përfundoni konfigurimin me sukses për 5 minuta, lavatriçja do të fiket automatikisht. Në këtë rast, do të duhet të filloni procedurën e konfigurimit nga e para. Nëse problemi vazhdon, ju lutemi të kontaktoni Agjentin e Autorizuar të Shërbimit.
- Mund ta përdorni lavatriçen tuaj me më shumë se një pajisje inteligjente. Për ta bërë këtë, shkarkoni aplikacionin HomeWhiz në pajisjen tjetër inteligjente. Pasi të nisni aplikacionin, do të duhet të identifikoheni me llogarinë që keni krijuar më parë dhe të çiftuar me lavatriçen tuaj. Përndryshe, ju lutemi të lexoni "Konfigurimi i lavatriçes që është e lidhur me llogarinë e dikujt tjetër".



PARALAJMËRIM!

- Për konfigurimin HomeWhiz, pajisja juaj inteligjente duhet të lidhet me internetin. Përndryshe, aplikacioni HomeWhiz nuk do t'ju lejojë të përfundoni me sukses procedurën e konfigurimit. Nëse keni probleme me lidhjen tuaj në internet, ju lutemi të kontaktoni ofruesin e shërbimit të internetit.



INFORMACION

- Aplikacioni HomeWhiz mund t'ju kërkojë të shkruani numrin e produktit të shënuar në etiketën e produktit. Etiketa e produktit gjendet në anën e brendshme të derës së produktit. Numri i produktit është shkruar në këtë etiketë.



5.21.2 Konfigurimi i lavatriçes që është e lidhur me llogarinë e dikujt tjetër

Nëse lavatriça që dëshironi të përdorni është regjistruar më parë në sistem me llogarinë e dikujt tjetër, duhet të krijoni një lidhje të re ndërmjet aplikacionit tuaj HomeWhiz dhe pajisjes.

- Shkarkoni aplikacionin HomeWhiz në pajisjen e re inteligjente që dëshironi të përdorni.
- Krijoni një llogari të re dhe hyni në këtë llogari në aplikacionin HomeWhiz.
- Ndiqni hapat në Setup HomeWhiz (5.21.1 Konfigurimi i HomeWhiz) për të përfunduar konfigurimin.



PARALAJMËRIM!

- Meqenëse funksioni HomeWhiz dhe ai i telekomandës së produktit tuaj funksionojnë nëpërmjet çiftimit me Bluetooth, produkti mund të funksionojë vetëm nga një aplikacion HomeWhiz në të njëjtën kohë.



PARALAJMËRIM!

- Numri i pajisjeve inteligjente që mund të çiftohen me produktin është i kufizuar. Nëse tejkaloni këtë limit, pajisja e parë në listën e pajisjeve të çiftuara do të fshihet. Në këtë rast, do të duhet të përsërisni procedurën e konfigurimit për atë produkt.

5.21.3 Përdorimi i funksionit të telekomandës

Pas konfigurimit të HomeWhiz, Bluetooth do të ndizet automatikisht. Për të aktivizuar ose çaktivizuar lidhjen me Bluetooth, shihni 5.11.2 Bluetooth 3''.

Nëse e fikni dhe ndizni lavatriçen kur Bluetooth është i aktivizuar, do të rilidhet automatikisht. Nëse pajisja e çiftuar del jashtë intervalit, lidhja Bluetooth do të fiket automatikisht. Për këtë arsye, do të duhet të aktivizoni përsëri funksionin Bluetooth nëse dëshironi të përdorni funksionin e telekomandës.

Mund të kontrolloni simbolin e Bluetooth në ekran për të ndjekur gjendjen tuaj të lidhjes. Nëse simboli është i ndezur, kjo do të thotë se lidhja Bluetooth është vendosur. Nëse simboli pulson, pajisja po përpiqet të lidhet. Nëse simboli është i fikur, kjo do të thotë se nuk keni lidhje.



PARALAJMËRIM!

- Nëse lidhja me Bluetooth është aktive në produktin tuaj, mund të zgjidhni funksionin e telekomandës. Nëse funksioni i telekomandës nuk mund të zgjidhet, kontrolloni gjendjen e lidhjes. Nëse lidhja dështon, përsëritni cilësimet e konfigurimit fillestar në pajisje.
- Për arsye sigurie, dera e produktit do të mbetet e kyçur, ndërsa funksioni i telekomandës është i aktivizuar, pavarësisht modalitetit të funksionimit. Nëse dëshironi të hapni derën e pajisjes, do të duhet ta ktheni çelësin e përzgjedhjes së programit ose të shtypni çelësin e telekomandës për të çaktivizuar funksionin e telekomandës.

Kur doni ta kontrolloni lavatriçen nga distanca, aktivizoni funksionin e telekomandës duke shtypur butonin e telekomandës ndërsa çelësi i programit është në pozicionin e butonit Shkarkoni programin/pozicionin i telekomandës në panelin e kontrollit. Sapo të keni qasje në pajisjen tuaj, do të shihni një ekran të ngjashëm si më poshtë.



Kur të aktivizohet telekomanda, mund të menaxhoni dhe fikni lavatriçen, si dhe të ndiqni statusin e saj. Gjithashtu të gjitha funksionet, përveç kyçit për fëmijët, mund të menaxhohen përmes aplikacionit.

Mund të ndiqni treguesin e funksionit në buton nëse funksioni i telekomandës është i ndezur ose i fikur.

Nëse funksioni i telekomandës është i fikur, të gjitha proceset kryhen në lavatriçe dhe vetëm në aplikacion lejohet ndjekja e statusit.

Nëse funksioni i telekomandës nuk mund të aktivizohet, do të dëgjoni një mesazh paralajmërues pas shtypjes së butonit. Kjo mund të ndodhë nëse produkti është i ndezur ose nëse nuk ka produkte të çiftuara përmes Bluetooth. Disa shembuj të këtyre rasteve janë cilësimet e funksionit Bluetooth të fikura ose dera e lavatriçes e hapur.

Kur aktivizoni këtë funksion në lavatriçe, funksioni i përmendur do të mbetet aktiv, përveç rasteve të caktuara, duke ju lejuar të kontrolloni në distancë lavatriçen nëpërmjet Bluetooth.

Në raste të caktuara, ai çaktivizohet për arsye sigurie:

- Kur lavatriçja ka një ndërprerjeje të energjisë.
- Kur butoni i programit është rrotulluar për të zgjedhur një program tjetër ose kur produkti është i fiksuar.

5.21.4 Zgjidhja e problemeve

Ndiqui hapat e mëposhtëm në qoftë se keni probleme me kontrollin ose lidhjen. Vëzhgoni nëse problemi vazhdon ose jo pas veprimit që keni kryer. Veproni si më poshtë nëse problemi nuk zgjidhet.


- Kontrolloni nëse pajisja juaj inteligjente është e lidhur me rrjetin përkatës në shtëpi.
- Rindizni sërish aplikacionin e pajisjes.
- Fikeni Bluetooth dhe pastaj ndizeni nëpërmjet panelit të kontrollit të përdoruesit.
- Nëse lidhja nuk mund të krijohet me proceset e mësipërme, përsëritni cilësimet e konfigurimit fillestar në pajisje.

Nëse problemi vazhdon, kontaktoni Agjentin e Autorizuar të Shërbimit.

6 Mirëmbajtja dhe pastrimi

Jetëgjatësia e shërbimit të produktit zgjatet dhe problemet e hasura shpesh pakësohen nëse pastrohet në intervale të rregullta.

6.1 Pastrimi i sirtarit të detergjentit



Pastroni sirtarin e detergjentit në intervale të rregullta (çdo 4-5 cikle larjeje) siç tregohen më poshtë me qëllim që të parandaloni grumbullimin e pluhurit të detergjentit me kalimin e kohës.

- 1 Hiqni sifonin duke e ngritur nga mbrapa siç tregohet në figurë. Pasi të keni bërë procedurat e përmendura më poshtë për pastrimin, vendoseni përsëri sifonin në vend dhe shtyjeni pjesën e tij përpara poshtë për t'u siguruar që të kapen kapëset.



INFORMACION

- Nëse mbetet përzierje uji dhe zbutësi më shumë se sasia normale në ndarjen e zbutësit, duhet pastruar sifoni.

2. Pastroni sirtarin e detergjentit dhe sifonin me shumë ujë të vakët në një lavaman. Për të mos lejuar mbetjet të bien në kontakt me lëkurën, pastrojeni me një furçë të përshtatshme duke veshur një palë doreza.
- 3 Vendosni sirtarin në vendin e tij pas pastrimit dhe sigurohuni që të mbyllet plotësisht.

6.2 Pastrimi i derës së ngarkesës dhe kazanit

Për produktet me program për pastrimin e kazanit, ju lutem shikoni Përdorimi i produktit – Programet.



Pas çdo larjeje dhe tharjeje sigurohuni që të mos mbeten substanca të huaja në kazan. Nëse vrimat e treguara në figurë janë të bllokuara, hapni vrimat duke përdorur kunjë dhëmbësh.



INFORMACION

- Substancat e metaleve të huaja do të shkaktojnë njolla ndryshku në kazan. Pastrojini njollat në sipërfaqen e kazanit duke përdorur agjentë pastrues për çelik inoxi. Mos përdorni asnjëherë lësh çeliku apo tel lësh.




KUJDES!

- Mos përdorni asnjëherë sfungjer apo materiale fërkimi. Kjo do të dëmtojë sipërfaqet e lyra, prej kromi dhe plastike.

6.3 Pastrimi i trupit dhe panelit të kontrollit

Fshijeni trupin e makinerisë me ujë me sapun ose detergjentë xhel të butë siç duhet, dhe thajeni me një copë të butë. Përdorni vetëm një copë të butë të thatë për të pastruar panelin e kontrollit.

6.4 Pastrimi i filtrave të marrjes së ujit



Ka një filtër në fund të çdo valvule për marrjen e ujit në pjesën e pasme të makinerisë dhe gjithashtu në të fund të çdo tubi të marrjes së ujit që janë të lidhur me rubinetin. Këta filtra parandalojnë hyrjen e substancave të huaja dhe papastërtive të ujit në makinën larëse.

Filtrat duhen pastruar nëse janë të pistë.

- Mbyllni rubinetet.
- Hiqni vidat nga tubat e shkarkimit të ujit për të arritur filtrat në valvulat e marrjes së ujit. Pastroni mbetejet në to me një furçë të përshtatshme. Nëse filtrat janë shumë të pistë, hiqini nga vendet me një pincë dhe pastrojini në këtë mënyrë.
- Hiqini filtrat në pjesët fundore të sheshta të tubave të marrjes së ujit bashkë me rrondelet dhe pastrojini tërësisht me ujë të rrjedhshëm.
- Rivendosni rrondelet dhe filtrat me kujdes në vendet e tyre dhe shtrëngojini vidat e tubit me dorë.

6.5 Shkarkimi i ujit të mbetur dhe pastrimi i filtrit të pompës.

Sistemi i filtrimit në lavatriçen tuaj parandalon që gjërat e forta si kopsat, monedhat dhe fibrat e materialeve të mos bllokojnë helikëen e pompës gjatë shkarkimit të ujit. Prandaj, uji do të shkarkohet pa problem dhe jetëgjatësia e shërbimit të pompës do të zgjatet.

Nëse makineria nuk e bën shkarkimin e ujit, filtri i pompës është i bllokuar. Filtri duhet të pastrohet kur ai bllokohet ose çdo 3 muaj. Uji duhet të shkarkohet paraprakisht për të pastruar filtrin e pompës. Përveç kësaj, para se të transportoni makinerinë (p.sh. kur lëvizni në një shtëpi tjetër) dhe në rastin e ujit të ngrirë, uji mund të duhet që të shkarkohet plotësisht.



KUJDES!

- Substancat e huaja të lëna në filtrin e pompës mund ta dëmtojnë produktin ose të shkaktojnë probleme zhurme.
- Nëse produkti nuk përdoret, mbylleni rubinetin, hiqni tubin e ujit dhe tubin e shkarkimit dhe vendoseni lavatriçen në vende ku nuk ka rrezik të ngrijës.
- Pas çdo përdorimi, mbyllni rubinetin e ujit me të cilin lidhet tubacioni i ujit.


- Për të pastruar filtrin e pompës dhe për të zbratur ujin, hiqeni lavatriçen nga priza për të ndërprerë energjinë.




KUJDES!

- Temperatura e ujit brenda makinerisë mund të ngrihet deri në 90 °C. Për të shmangur rrezikun e djegies, pastrojini filtrin pasi uji brenda lavatriçes të jetë ftohur.

2. Hapni kapakun e filtrit. Shtypeni kapësen në drejtimin e shigjetës dhe tërhiqeni kapakun drejt vetes.



3. Për të zbrazur ujin në lavatriçe.



- Për të grumbulluar ujin që del jashtë filtrit, vendosni një enë të madhe të cekët përpara filtrit.
 - Rrotulloni dhe lironi filtrin e pompës derisa të fillojë të dalë uji (kundërorar). Futeni ujin që rrjedh në enën që vendosët përballë filtrit. Mbani gjithmonë një copë leckë të dobishme për të thithur ujin që del jashtë.
 - Kur uji brenda makinerisë mbaron, hiqeni filtrin tërësisht duke e rrotulluar.
4. Pastroni çdo mbetje brenda filtrit dhe gjithashtu fibrat, nëse ka, rrotull zonës të helikës të pompës.
5. Vendosni përsëri filtrin.
6. Mbylleni kapakun e filtrit.

7 Zgjidhja e problemeve

Programet nuk fillojnë pasi dera e ngarkimit të jetë mbyllur.

- Nuk keni shtypur butonin Start/Pause/Cancel.>>> *Shtypni butonin Start/Pause/Cancel.
- Nëse ngarkesa është shumë e madhe, mund të jetë e vështirë që dera e ngarkimit të mbyllet.>>> *Ngarkoni më pak roba dhe sigurohuni që dera e ngarkimit të jetë e mbyllur siç duhet.

Programi nuk mund të nisët apo përzgjidhet.

- Lavatriça mund të ketë kaluar në mënyrë automatike në modalitetin mbrojtës për shkak të një problemi me furnizimin (tensioni i energjisë, presioni i ujit, etj.).>>> Shtypni dhe mbani shtypur butonin On/Off për 3 sekonda për ta kthyer lavatriçen në parametrat e fabrikës. (Shihni "Anulimi i programit")

Brenda në lavatriçe ka ujë.

- Mund të ketë mbetur një sasi uji në produkt për shkak të proceseve të kontrollit të cilësisë në prodhim.>>> Ky nuk është një defekt; uji nuk është i dëmshëm për lavatriçen.

Ka rrjedhje uji nga fundi i lavatriçes.

- Mund të ketë ndonjë problem me tubat ose filtrin e pompës.>>> Sigurohuni që gominat e tubave të hyrjes së ujit të jenë shtërnguar mirë. Lidhni fort tubin me rubinetin.
- Filtri i pompës nuk është mbyllur mirë.>>> Sigurohuni që filtri i pompës të mbyllur mirë.

Lavatriça nuk e merr ujin.

- Rubineti mund të jetë i mbyllur.>>> Hapni rubinetet.
- Tubi i hyrjes së ujit mund të jetë përdredhur.>>> Drejtoni tubin.
- Filtri i hyrjes së ujit mund të jetë bllokuar.>>> Pastroni filtrin.
- Dera e ngarkimit mund të mos jetë mbyllur.>>> Mbyllni derën e ngarkimit.

Lavatriça nuk e shkarkon ujin.

- Tubi i shkarkimit të ujit mund të jetë bllokuar ose përdredhur.>>> Pastroni ose drejtoni tubin.
- Filtri i pompës mund të jetë bllokuar.>>> Pastroni filtrin e pompës.

Lavatriça dridhet ose bën zhurmë.

- Lavatriça mund të mos jetë e balancuar.>>> Rregulloni këmbët që të vendosni në nivel lavatriçen.
- Një substancë e fortë mund të ketë hyrë në filtrin e pompës.>>> Pastroni filtrin e pompës.
- Bulonat e sigurisë së transportit mund të mos jenë hequr.>>> Hiqni bulonat e sigurisë së transportit.
- Sasia e rrobave mund të jetë shumë e vogël.>>> Shtoni më shumë roba në lavatriçe.
- Lavatriça mund të jetë mbingarkuar me roba.>>> Hiqni disa nga rrobat nga lavatriça ose shpërndajeni me dorë ngarkesën për ta balancuar në mënyrë të njëtrajtshme në lavatriçe.
- Lavatriça mund të jetë në kontakt me një sipërfaqe të fortë.>>> Sigurohuni që lavatriça të mos bjerë në kontakt me asgjë.

Lavatriçja ndaloi pak pasi filloi programi.

- Lavatriçja mund të ketë ndaluar përkohësisht për shkak të tensionit të ulët. >>> Do të rifillojë punën kur tensioni të vijë në nivelin normal.

Lavatriçja e shkarkon direkt ujin që merr brenda.

- Tubi i shkarkimit mund të jetë në një lartësi të papërshtatshme. >>> Lidhni tubin e shkarkimit të ujit siç përshkruhet në manualin e përdorimit.

Nuk shihet ujë në lavatriçe gjatë larjes.

- Niveli i ujit nuk mund të shihet nga jashtë lavatriçes. Ky nuk është defekt.

Dera e ngarkimit nuk mund të hapet.

- Bllokimi i derës mund të jetë aktivizuar për shkak të nivelit të ujit në lavatriçe. >>> Shkarkoni ujin duke vënë në punë programin e Pompës ose Centrifugës.
- Lavatriçja mund të jetë duke ngrohur ujin ose në fazën e centrifugimit...>>> Prisni derisa programi të përfundojë.
- Dera e ngarkimit mund të jetë e bllokuar për shkak të presionit të ushtruar. >>> Kapni dorezën, shtyni dhe tërhiqni derën e ngarkimit për ta liruar atë nga presioni dhe hapeni atë.
- Dera e ngarkimit nuk do të hapet nëse nuk ka energji. >>> Për të hapur derën e ngarkimit, hapni kapakun e filtrit të pompës dhe ulni poshtë dorezën e emergjencës që ndodhet në anën e pasme të kapakut të lartpërmendur. Shihni "Kycja e derës së ngarkimit"

Larja merr më shumë kohë nga sa tregohet në manualin e përdorimit.(*)

- Presioni i ujit mund të jetë i ulët. >>> Meqenëse sasia e ujit është ulur, lavatriçja do të presë derisa të marrë ujë të mjaftueshëm për të shmangur cilësinë e dobët të larjes. Prandaj, koha e larjes zgjat më shumë.
- Tensioni mund të jetë i ulët. >>> Nëse tensioni i furnizimit është i ulët, koha e larjes zgjatet për të parandaluar cilësinë e dobët të larjes.
- Temperatura e hyrjes së ujit mund të jetë e ulët. >>> Koha që kërkohet për të ngrohur ujin zgjat më shumë në stinët e ftohta. Gjithashtu, koha e larjes mund të zgjatet për të shmangur rezultate të dobëta të larjes.
- Numri i cikleve të shpëlarjes dhe/ose sasia e ujit të shpëlarjes mund të jetë rritur. >>> Kur nevojitet një rendiment më i mirë i shpëlarjes, lavatriçja rrit sasinë e ujit të shpëlarjes dhe shton një cikël tjetër shpëlarjeje, nëse është e nevojshme.
- Mund të jetë formuar shumë e tepërt për shkak të përdorimit të një sasive të madhe detergjenti, si dhe mund të jetë aktivizuar sistemi i thithjes automatike të shumës. >>> Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit.

Koha e programit nuk numëron së prapthi. (Në modelet me ekran) (*)

- Kohëmatësi mund të ndalojë gjatë marrjes së ujit. >>> Treguesi i kohëmatësit nuk do të numërojë së prapthi derisa lavatriçja të marrë sasinë e nevojshme të ujit. Kur sasia e ujit të marrë ulet, lavatriçja do të presë derisa të marrë ujë të mjaftueshëm për të shmangur rezultatet e dobëta të larjes. Pas kësaj, treguesi i kohëmatësit do të rifillojë numërimin së prapthi.
- Kohëmatësi mund të ndalojë gjatë ngrohjes. >>> Treguesi i kohëmatësit nuk do të numërojë së prapthi derisa lavatriçja të ketë arritur temperaturën e përzgjedhur.
- Treguesi i kohëmatësit mund të ndalojë gjatë fazës së centrifugimit. >>> Sistemi i gjurmimit automatik të ngarkesës së pabalancuar mund të jetë aktivizuar për shkak të shpërndarjes së pabalancuar të rrobave në kazan.

Koha e programit nuk numëron së prapthi. (*)

- Shpërndarja e rrobave në lavatriçe mund të mos jetë e balancuar. >>> Sistemi i gjurmimit automatik të ngarkesës së pabalancuar mund të jetë aktivizuar për shkak të shpërndarjes së pabalancuar të rrobave në kazan.

Makina larëse nuk kalon në hapin e centrifugës. (*)

- Shpërndarja e rrobave në lavatriçe mund të mos jetë e balancuar. >>> Sistemi i gjurmimit automatik të ngarkesës së pabalancuar mund të jetë aktivizuar për shkak të shpërndarjes së pabalancuar të rrobave në kazan.
- Lavatriçja nuk bën centrifugën nëse uji nuk zbrazet plotësisht. >>> Kontrolloni filtrin dhe tubin e shkarkimit.
- Mund të jetë formuar shumë e tepërt për shkak të përdorimit të një sasive të madhe detergjenti, si dhe mund të jetë aktivizuar sistemi i thithjes automatike të shumës. >>> Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit.

Rendimenti i larjes është i dobët: Rrobat marrin ngjyrë gri.()**

- Është përdorur sasi e pamjaftueshme detergjenti për një kohë të gjatë. >>> Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit sipas fortësisë së ujit dhe llojit të rrobave.
- Larja është bërë me temperatura të ulëta për një kohë të gjatë. >>> Zgjidhni temperaturën e duhur për larjen e rrobave.
- Ujë i fortë dhe sasi e pamjaftueshme e detergjentit. >>> Përdorimi i ujit të fortë së bashku me sasinë e pamjaftueshme të detergjentit mund të shkaktojë akumulim të ndyrësive dhe ngjyrosjen gri të rrobave me kohën. Është e vështirë të eliminohet ngjyrimi në gri, pasi ai të ketë ndodhur. Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit të përshtatshëm për fortësinë e ujit dhe llojin e rrobave.
- Mund të jetë përdorur sasi e tepërt detergjenti. >>> Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit, që i përshtatet fortësisë së ujit dhe rrobave.

Rendimenti i larjes është i dobët: Njollat nuk hiqen ose rrobat nuk zbardhen. ()**

- Mund të jetë përdorur sasi e pamjaftueshme detergjenti. >>> Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit për llojin e rrobave.
- Lavatrica mund të ketë qenë e mbingarkuar. >>> Mos e mbingarkoni lavatriçen. Ngarkoni lavatriçen me sasi të rekomanduara në "Tabela e programeve dhe konsumit".
- Mund të jetë zgjedhur programi dhe temperatura e gabuar. >>> Zgjidhni temperaturën dhe programin e duhur për rrobat që do të lahen.
- Mund të jetë përdorur lloji i gabuar i detergjentit. >>> Përdorni detergjent origjinal të përshtatshëm për lavatriçen.
- Detergjenti mund të jetë vendosur në ndarjen e gabuar. >>> Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur. Mos e përzieni agjentin zbardhues dhe detergjentin me njëri-tjetrin.

Rendimenti i larjes është i dobët: Në rroba janë shfaqur njolla yndyre. ()**

- Kazani mund të mos jetë pastruar rregullisht. >>> Pastrojeni kazanin rregullisht. Për ta bërë këtë, ju lutem shikoni. 6.2.

Rendimenti i larjes është i dobët: Rrobat mbajnë erë të keqe. ()**

- Larja në temperatura të ulëta dhe/ose me programe të shkurtra për një kohë të gjatë do të shkaktojë erë dhe baktere në kazan. >>> Lëreni sirtarin e detergjentit dhe derën e ngarkimit të makinës paksa të hapur pas çdo cikli të larjes. Në këtë mënyrë, në lavatriçe nuk do të krijohet një ambient i lagësht i favorshëm për bakteret.

Ngjyra e rrobave është zbehur. ()**

- Lavatrica mund të ketë qenë e mbingarkuar. >>> Mos e mbingarkoni lavatriçen.
- Detergjenti mund të jetë i njomë. >>> Mbajini detergjentët në ambiente pa lagështi dhe mos i ekspozoni në temperatura ekstreme.
- Mund të jetë zgjedhur një temperaturë e lartë. >>> Zgjidhni programin dhe temperaturën e duhur sipas llojit dhe shkallës së njollave të rrobave.

Rendimenti i shpëlarjes është i dobët

- Sasia, marka dhe kushtet e ruajtjes së detergjentit të përdorur mund të mos jenë të përshtatshme. >>> Përdorni një detergjent të përshtatshëm për lavatriçe dhe për rrobat tuaja. Mbajini detergjentët në ambiente pa lagështi dhe mos i ekspozoni në temperatura ekstreme.
- Detergjenti mund të jetë shtuar në ndarjen e gabuar. >>> Nëse shtoni detergjent në ndarjen e paralarjes, edhe nëse nuk keni zgjedhur një program paralarjeje, lavatrica mund ta marrë këtë detergjent gjatë hapit të shpëlarjes ose zbutjes. Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur.
- Filtri i pompës mund të jetë bllokuar. >>> Kontrolloni filtrin.
- Tubi i shkarkimit mund të jetë palosur. >>> Kontrolloni tubin e shkarkimit.

Rrobat bëhen të ngurta pas larjes. ()**

- Mund të jetë përdorur sasi e pamjaftueshme detergjenti. >>> Përdorimi i sasisë së pamjaftueshme të detergjentit për fortësinë e ujit mund të shkaktojë që rrobat të bëhen të ngurta me kalimin e kohës. Përdorni sasinë e duhur të detergjentit sipas fortësisë së ujit.
- Detergjenti mund të jetë shtuar në ndarjen e gabuar. >>> Nëse shtoni detergjent në ndarjen e paralarjes, edhe nëse nuk keni zgjedhur një program paralarjeje, lavatrica mund ta marrë këtë detergjent gjatë hapit të shpëlarjes ose zbutjes. Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur.
- Detergjenti mund të jetë përzier me zbutës. >>> Mos e përzieni detergjentin me zbutësin. Lajeni dhe pastrojeni sirtarin me ujë të nxehtë.

Rrobat nuk mbajnë erën e zbutësit. ()**

- Detergjenti mund të jetë shtuar në ndarjen e gabuar. >>> Nëse shtoni detergjent në ndarjen e paralarjes, edhe nëse nuk keni zgjedhur një program paralarjeje, lavatrica mund ta marrë këtë detergjent gjatë hapit të shpëlarjes ose zbutjes. Lajeni dhe pastrojeni sirtarin me ujë të nxehtë. Vendosni detergjentin në ndarjen e duhur.
- Detergjenti mund të jetë përzier me zbutës. >>> Mos e përzieni detergjentin me zbutësin. Lajeni dhe pastrojeni sirtarin me ujë të nxehtë.

Mbetje detergjenti në sirtarin e detergjentit. ()**

- Detergjenti mund të jetë shtuar në sirtarin e lagësht. >>> Thajeni sirtarin para se të shtoni detergjent.
- Detergjenti mund të jetë njomur. >>> Mbajini detergjentët në ambiente pa lagështi dhe mos i ekspozoni në temperatura ekstreme.
- Presioni i ujit mund të jetë i ulët. >>> Kontrolloni presionin e ujit.
- Detergjenti në ndarjen kryesore të larjes është njomur ndërsa lavatrica po merrte ujin për paralarjen. Vrimat në ndarjen e detergjentit mund të jenë bllokuar. >>> Kontrolloni vrimat dhe pastrojeni nëse janë bllokuar.
- Mund të ketë një problem me valulat e sirtarit të detergjentit. >>> Thërrisni Agjentin e Autorizuar të Shërbimit.
- Detergjenti mund të jetë përzier me zbutës. >>> Mos e përzieni detergjentin me zbutësin. Lajeni dhe pastrojeni sirtarin me ujë të nxehtë.

Ka mbetur detergjent në rroba.

- Lavatrica mund të ketë qenë e mbingarkuar. >>> Mos e mbingarkoni lavatriçen.
- Mund të jetë zgjedhur programi dhe temperatura e gabuar. >>> Zgjidhni temperaturën dhe programin e duhur për rrobat që do të lahen.
- Mund të jetë përdorur detergjenti i gabuar. >>> Zgjidhni detergjentin e duhur për larjen e rrobave.

Në lavatriçe formohet shkumë e tepërt. (**)

- Mund të jenë përdorur detergjentë të papërshtatshëm për lavatriçe. >>> Përdorni detergjente të përshtatshme për lavatriçe.
- Mund të jetë përdorur sasi e tepërt detergjenti. >>> Përdorni vetëm sasinë e mjaftueshme të detergjentit.
- Detergjenti mund të jetë ruajtur në kushte të papërshtatshme. >>> Mbajeni detergjentin në një zonë të mbyllur dhe të thatë. Mos e ruani në vende tepër të nxehta.
- Rrobat në formë rrjeje, si tyli mund të shkurtojnë shumë për shkak të teksturës së tyre. >>> Përdorni më pak detergjent për këto lloje të pëlhurave.
- Detergjenti mund të jetë vendosur në ndarjen e gabuar. >>> Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur.
- Zbutësi është marrë herët. >>> Mund të ketë një problem në valvulat ose në sirtarin e detergjentit. Thërrisni Agjentin e Autorizuar të Shërbimit.

Nga sirtari i detergjentit po derdhet shkumë.

- Mund të jetë përdorur sasi e tepërt detergjenti. >>>>Përzieni 1 lugë çaji zbutës dhe 1/2 L ujë dhe hidheni në ndarjen kryesore të sirtarit të detergjentit.
- Vendosni në lavatriçe detergjent të përshtatshëm me programet dhe ngarkesat maksimale të treguara në "Tabelën e programit dhe konsumit". Kur përdorni kimikate shtesë (heqës njollash, zbardhues e kështu me radhë), ulni sasinë e detergjentit.

Rrobat mbeten të lagura në fund të programit. (*)

- Mund të jetë formuar shkumë e tepërt për shkak të përdorimit të një sasive të madhe detergjenti, si dhe mund të jetë aktivizuar sistemi i thithjes automatike të shkumës. >>> Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit.

Tharja zgjat shumë.

- Lavatriça mund të ketë qenë e mbingarkuar. >>> Mos e mbingarkoni lavatriçen.
- Centrifugimi mund të mos jetë i mjaftueshëm për rrobat. >>> Zgjidhni një shpejtësi më të lartë të centrifugimit në hapin e larjes së pajisjes larëse-tharëse.
- Rubineti mund të jetë i mbyllur. >>> Hapni rubinetet.

Rrobat dalin të lagura pas hapit të tharjes.

- Programi i përzgjedhur mund të mos jetë i përshtatshëm për llojin e rrobave. >>>Kontrolloni etiketat e mirëmbajtjes në veshje dhe zgjidhni një program në përputhje me udhëzimet, ose zgjidhni programet me kohë shtesë.
- Lavatriça mund të ketë qenë e mbingarkuar. >>> Mos e mbingarkoni lavatriçen.
- Centrifugimi mund të mos jetë i mjaftueshëm për rrobat. >>> Zgjidhni një shpejtësi më të lartë të centrifugimit në hapin e larjes së pajisjes larëse-tharëse.

Lavatriça nuk fillon ose programi nuk fillon.

- Mund të mos jetë futur në prizë kabli i energjisë. >>> Sigurohuni që kabli i energjisë të jetë futur në prizë.
- Programi mund të mos jetë caktuar ose mund të mos jetë shtypur butoni Start/Pause/Cancel. >>> Sigurohuni që programi të jetë caktuar dhe lavatriça të mos jetë në modalitetin e Ndalesës.
- Kyçi i fëmijëve mund të jetë aktivizuar. >>> Çaktivizoni kyçin e fëmijëve.

Rrobat tkurren, çngjyrosen, prishen ose dëmtohen.

- Programi i përzgjedhur mund të mos jetë i përshtatshëm për llojin e rrobave. >>>Kontrolloni etiketat e mirëmbajtjes në veshje dhe zgjidhni një program në përputhje me udhëzimet, ose zgjidhni programet me kohë shtesë. Nuk duhet të thani rroba që nuk janë të përshtatshme për tharje.

Lavatriça nuk e bën tharjen.

- Rrobat mund të mos jenë të thata ose nuk është aktivizuar hapi i tharjes. >>> Kontrolloni nëse është zgjedhur gjithashtu funksioni i tharjes pas programit të zgjedhur të larjes.

Dera e ngarkimit nuk mund të hapet.

- Dera e lavatriçes suaj mund të mos hapet për arsye sigurie. >>>Nëse treguesi i derës së kyçur është aktiv në ekran pas hapit të tharjes, lavatriça do ta mbajë derën të kyçur për sigurinë tuaj, derisa të ftohet.
- Dera e ngarkimit nuk do të hapet nëse nuk ka energji. >>> Për të hapur derën e ngarkimit, hapni kapakun e filtrit të pompës dhe ulni poshtë dorezën e emergjencës që ndodhet në anën e pasme të kapakut të lartpërmendur. Shihni "Kycja e derës së ngarkimit"

(*) Lavatriça nuk kalon në fazën e centrifugës kur rrobat nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në kazan për të parandaluar ndonjë dëmtim të makinerisë dhe mjedisit rrethues. Rivendosni rrobat dhe kryeni sërish centrifugimin.

(**) Kazani mund të mos jetë pastruar rregullisht. >>> Pastrojeni kazanin rregullisht. Shikoni 6.2



KUJDES!

- Nëse nuk mund ta eliminoni problemin megjithëse keni ndjekur udhëzimet në këtë pjesë, konsultohuni me shitësin ose Agjentin e Autorizuar të Shërbimit. Mos u përpiqni asnjëherë të rregulloni vetë një produkt që nuk funksionon.



PARALAJMËRIM!

- Kontrolloni seksionin HomeWhiz për informacionet përkatëse lidhur me zgjidhjen e problemeve.